



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.254, datë 23.07.2021

MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS PËR PROKUROREN DHORINA THEODHORI, KANDIDATE PËR POZICIONIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KORÇË

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 159, pika 1 dhe 2 germa “a”, 184 dhe 189, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 52, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikën 5, të nenit 9, të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, miratuar me Vendimin nr. 200, datë 23.09.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe në germën “ç”, pika 8, Seksioni Ç, të Kreut VI, të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, i ndryshuar si dhe pasi u njoh me Relacionin “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës për prokuroren Dhorina Theodhori, candidate për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për prokuroren Dhorina Theodhori, candidate për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.
2. Lejimin e kandidates prokurore Dhorina Theodhori të vijojë me procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës së Parë Korçë.
3. Të njoftohet për këtë vendim znj. Dhorina Theodhori.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**





**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR
MOISI DUDA**

**ANËTAR
VATË STAKA**

**ANËTAR
SANDËR BECI**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**